



“Vrasje në tentativë” – policia shpalos detaje për dy të dyshuarit e viktimën nga plagosja në Prizren



10/10/2023 18:50



Policia ka dhënë detaje për “vrasjen në tentativë” të ndodhur sot në rrugën “Transiti i vjetër” në Prizren.

Policia njofton se pas një zënke në mes të viktimës mashkull kosovar shqiptar, viti i lindjes 1966 dhe të dyshuarve Sh.M. (viti i lindjes 1993) dhe D.M. (viti i lindjes 1991), dyshohet se njëri nga të dyshuarit ka shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës me ç’ rast i ka shkaktuar lëndime trupore.

Viktima ka pranuar trajtim mjekësor dhe është jashtë rrezikut për jetën, ndërsa policia ka arrestuar dy të dyshuar.

Lidhur me rastin është konfiskuar një revole dhe gjashtë fishekë.

Njoftimi i plotë i policisë:

Me datën 10.10.2023 rreth orës 14:30 Stacioni Policor Prizren ka pranuar informacion se në rrugën “Transiti i vjetër” në Prizren pas një zënke në mes të viktimës mashkull kosovar shqiptar, viti i lindjes 1966 dhe të dyshuarve Sh.M. (viti i lindjes 1993) dhe D.M. (viti i lindjes 1991), dyshohet se njëri nga të dyshuarit ka shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës me ç’ rast i ka shkaktuar lëndime trupore.

Njësitet policore relevante me urgjencë i janë përgjigjur rastit. Viktimës i është ofruar ndihmë mjekësore në qendrën emergjente në spitalin rajonal të Prizrenit dhe sipas mjekut kujdestar gjendja e tij është stabile.

Zyrtarëve policor kanë arrestuar dy të dyshuarit e lartëcekur dhe në vendin e ngjarjes është konfiskuar edhe një (1) revole e tipit Cervena Zastava e kalibrit 7.65 mm dhe gjashtë (6) fishekë të cilat do të përdorën dëshmi për gjykatën.

Rrethanat se si ka ndodhur rast në koordinim me prokurorin e shtetit janë duke u hetuar nga ana e njësiteve relevante të cilat kanë në vendin e ngjarjes, rasti i cili nga prokurori i shtetit është cilësuar “Vrasje në tentativë”.

Artikuj të ngjashëm




October 10, 2023

Dyshohet për armë, Policia e Kosovës me aksion në një depo...



October 10, 2023

Konjufca u drejtohet gjermanëve: Nëse s’merren masa ndaj Serbisë, ajo rrezikon...



October 10, 2023

Vrau nënën e tij duke i shkaktuar mbi 20 plagë, ngrihet...



October 10, 2023

Radoiçiqi vazhdon me filmin e radhës, heq dorë nga pronësia e...



October 10, 2023

Kurti krenohet me dy vjet e gjysmë mandat, lavdëron investimet në...



October 10, 2023

Forcat izraelite pretendojnë ta kenë vrarë ministrin palestinez të Ekonomisë...

LAJME TË FUNDIT



“Bashkëkriminele”, Arta Elezaj ia uron ditëlindjes emnakes së...



Ish-trajneri i Prishtinës e ndryshon mbiemrin, po mendon...



Pse “Euro 2028” nuk do të luhet në...



Dyshohet për armë, Policia e Kosovës me aksion...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information